



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.5, datë 21/05/2024

PËR

ANULIMIN E VENDIMIT NR.14, DATË 29.05.2023 TË LEJES NR.000094 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAËSOR PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE”, TË SUBJEKTIT “TETE ALBANIA TUNNEL MINING” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, dhe nenit 55, gërma c “Zgjidhja e kontratës koncesionare dhe shfuqizimi ose anulimi i autorizimeve dhe lejeve mund të bëhen në rastet kur: Me kërkesën e titullarit të autorizimit, lejes, koncesionit” me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së subjektit “Tete Albania Tunnel Mining” sh.p.k për anulimin e Vendimit nr.14, datë 29.05.2023 të Lejes Nr.000094 “për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime teknologjike”, me vendndodhje Fshati Gurth-Spaç, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë:
2. Vendndodhja e përcaktuar e burimit (KRGJSH) sipas Lejes Nr.000094:

- X= 503853.1; Y= 4640957.8; Z=515 m.m.n.d;

- Prurja mesatare : $Q_{mes} = 22.2$ l/s
- Sasia e ujit në përdorim : $Q = 4.8$ l/s
- Qëllimi i përdorimit : Industriale, Fabrikë Pasurimi mineral bakri.
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në Shtratin e përroit të Spaçit degë e lumit Fan.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

